



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201062/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i menjëhershëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së Sarandë.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Nasip HOXHA
Drejtore i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

SARANDË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Sarandë.

Inspektimi u krye më datë 01.09.2022, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Sarandë, garantimi i të drejtave dhe trajtimi i të paraburgosurve në bazë të akteve ligjore e nënligjore dhe dokumenteve ndërkombëtare në fuqi, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme¹.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në kqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, si dhe zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur.

¹ Shkresë nr. K4/I30-2 prot, datë 08.12.2021 "Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve në IEVP Sarandë".

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet e sistemit penitenciar, grupi i inspektimit u takua me Drejtorin e IEVP Sarandë z.Nasip Hoxha, i cili pas prezantimit u informua në lidhje me qëllimin e inspektimit, ambientet që do të inspektohen, intervistat që do të zhvilloheshin me të paraburgosurit, si dhe dokumentacionin që do të verifikohet, një kopje e të cilit do të vihej në dispozicion edhe të grupit të inspektimit.

Grupi i inspektimit kërkoi fillimisht nga Drejtori i IEVP-së një informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve në këtë IEVP, kushtet në të cilat ndodhen ambientet në regjimin e brendshëm, mënyrën e zgjidhjes nga ana e institucionit të kërkesë/ankesave të të paraburgosurve, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit pas inspektimit të mëparshëm.

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Sarandë për vitin 2022.

Nga informacioni rezultoi se, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018 “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Sarandë, është klasifikuar burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion siguri të zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Organika e institucionit përbëhet nga 51 punonjës, prej të cilëve 10 punonjës ishin staf civil dhe 41 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Aktualisht organika e IEVP Sarandë, përbëhet nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori ligjor, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor dhe sektori i policisë. Ky sektor, përbëhet nga 1 (një) mjek i përgjithshëm part-time, 3 (tre) ndihmës mjekë dhe 1 (një) farmacist. Në tërësi organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa në pozicionin e 1 (një) psikologu, në pozicionin e 8 (tetë) punonjësve të policisë të rolit bazë dhe në sektorin shëndetësor, në organikë nuk kishte stomatolog, por në raste urgjence të burgosurit në shoqërimin e stafit policor dërgoheshin në klinikat private.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë kishte një kapacitet maksimal prej 36 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 43 persona, pra 7 persona të paraburgosur mbi kapacitetin zyrtar.

Gjithashtu, grupi i inspektimit i kërkoi informacion Drejtorit të institucionit në lidhje me dokumentacionin ligjor që përcakton kapacitetin e IEVP-së. Drejtori i institucionit na informoi se nuk ka urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me kapacitetin zyrtar të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, por i referohen planit të ndërtimit të institucionit i cili është planifikuar me këtë kapacitet.

Në zbatim të nenit 33, pika 4 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, thuhet se në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve

Penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke u siguruar kubaturë jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se kapacitetet duhen të përcaktohen me urdhër nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kapacitetin zyrtar të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sipas pikës 4 të këtij neni, në lidhje me mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes, në mënyrë që të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe të plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit.

Në lidhje me situatën e popullimit në dhomat e banimit, morëm informacion nga drejtuesi i institucionit edhe për periudhën e fundit 6 mujore. Referuar statistikave të evidentuara nga inspektimi, situata e popullimit për këtë periudhë paraqitet si më poshtë vijon:

- Prill 45 persona ose 25%
- Maji 44 persona ose 22%
- Qershor 49 persona ose 36%
- Korrik 48 persona ose 35%
- Gusht 52 persona ose 44%
- Shtator 43 persona ose 21%

Nga inspektimi u konstatua se, një pjesë e të paraburgosurve që ishin mbi kapacitet, ishin të pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuara për 2, 4 dhe 6 persona, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese.

Fenomeni i mbipopullimit është konstant edhe në 6 mujorin e fundit të evidentuar sa më lart. Në vlerësimin tonë, nisur nga fakti se I EVP Sarandë është institucion paraburgimi, situata e mbipopullimit veç mungesës së kapaciteteve akomoduese, është në varësi edhe të dinamikës së vendimeve që marrin gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit në Vlorë. Ndaj në kushte të tilla është tepër e domosdoshme që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e cila bën planifikimin e kapaciteteve akomoduese për çdo I EVP, të kërkojë edhe shpërndarjen e të paraburgosurve në I EVP-të e tjera më të afërta, me prokuroritë dhe gjykatat e rrethit gjyqësor, pasi ambientet ku jetojnë të paraburgosurit e kësaj I EVP-je nuk garantojnë kushte trajtimi dinjitoz.

Është me rëndësi të bëhet ndarja e mësipërme për të sqaruar se vërehet mbipopullim në muajt e fundit, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues. Theksojmë se Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018, i ka rekomanduar autoriteteteve shqiptare se duhet të mbajnë në konsideratë mangësinë e përmbushjes së standardit minimal prej 4 m² të hapësirës për person, kur në to sistemohen më shumë persona (në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit që mund të ndodhet brenda dhomës), standard i cili duhet të respektohet plotësisht në praktikë.

Nga ana e drejtuesit dhe stafit të institucionit, grupit të inspektimit ju ofrua akses i plotë sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme, për kryerjen e inspektimit në të gjitha ambientet e institucionit, si dhe për zhvillimin e intervistave me personat e paraburgosur që vuanin dënimin në këtë institucion.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të datës 01.07.2021 të Institucionit të Avokatit të Popullit, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:

- **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për plotësimin e organikës së stafit mjekësor të institucionit me farmacist, por mungon mjeku dhe stomatologu me kohë të plotë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor.
- **Ishte zbatuar rekomandimi**, për përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
- **Ishte zbatuar rekomandimi**, për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien në punë të aparateve të telefonave që ndodhen në regjimin e brendshëm, për plotësimin e nevojave të të paraburgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, si dhe hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave.
- **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës së dhomës së observim/veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
- **Ishte zbatuar rekomandimi** për krijimin e ambienteve të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme.

Ndërkohë që, një pjesë e rekomandimeve të mëparëshme të paraqitura nga Avokati i Popullit, nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për rikonstrukcionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në IEVP Sarandë, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave për futjen e ajrit dhe dritës natyrale.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për përmirësimin e shërbimeve edukuese.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për adresimin dhe zgjidhjen e menjëhershme të çështjes së ambienteve të IEVP Sarandë, i cili shërbente si ambient për dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, në kushtet kur institucioni funksionon në mbipopullim dhe për mungesë ambienti nuk u ofron dot shërbimet e nevojshme të paraburgosurve të kësaj IEVP-je.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për garantimin e ambientit të përshtatshëm me hapësirë dhe të plotësuar me materialet e nevojshme, i destinuar për ushtrimin e detyrës të specialistëve të sektorit të edukimit.

- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e ilaçeve të të paraburgosurve nga skema e rimbursimit të ilaçeve, duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për hapjen e njësisë tregtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të paraburgosurit në IEVP Sarandë.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për riorganizimin dhe vënien në efikasitet të punës së sektorit psiko-social të institucionit; shtimin e kontakteve të vazhdueshme dhe periodike të stafit psiko-social me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, riintegrimi; si dhe nxitjen e organizimit dhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të paraburgosurit, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në institucion.
- **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat e të burgosurve.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit të disa praktikave sipas sektorëve, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë.
- Praktikën e masave disiplinore.
- Fotokopjen e kontratës individuale të punës.
- Praktikën e punës së Komisionit të Pritjes.

Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese grupi i inspektimit vizitoi dhe kontaktoi me të paraburgosurit në ambientet e IEVP Sarandë, me qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative² apo ushtrimin të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion dhe komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e këtij institucioni. Sikurse ata pohuan, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit janë të mira dhe korrekte.

² Neni 2, Parimet e Përgjithshme, Rregulloret e Përgjithshme e Burgjeve.

Nga intervistat me të paraburgosurit ata ngritën ankesa që kishin të bënin me hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që në dhoma ishin të akomoduar 2, 4 dhe 6 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standardit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Me tej në intervistat me të paraburgosurit rezultoi një numër i madh ankesash, që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion, si dhe me mungesën e psikologut dhe doktorit me kohë të plotë, duke mos patur shërbimet e duhura nga sektori psiko-social dhe ai shëndetësor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se punonjësit përgjegjës të institucionit **nuk kishin** krijuar dosje psiko-sociale për të paraburgosurit.

Neglizhenca nga ana e drejtuesve të institucionit për emërimin e një psikologu sipas strukturës ka sjellë gjetjen kjo e përsëritur mungesë trajtimi social-edukativ të të paraburgosurve me qëllim uljen e stresit dhe të ankthit dhe mungesë të aktiviteteve individuale si dhe veprimtarive formuese specifike. Të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve me karakter kulturor dhe edukativ, për të cilët institucioni nuk ka ambiente të veçanta për zhvillimin e tyre.

Në intervistat konfidenciale me personat e paraburgosur, u ngritën disa ankesa që kishin të bënin me nevojën e një prezence më të madhe të juristit të institucionit në takimet periodike që zhvillojnë, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimeve të nevojshme në lidhje me të drejtat që ju garanton ligji në rastin e kërkesave për transferime dhe lejeve shpërblyese, si dhe nevojën e respektimit të këtyre të drejtave nga ana e stafit dhe punonjësve të policisë të institucionit.

Në këtë aspekt ankesat më të shumta që ju paraqitën grupit të inspektimit nga të paraburgosurit, kishin të bënin me pretendimin për vendime të etiketuara prej tyre si të “padrejta” që marrin organi i prokurorisë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore për veprat penale që ju atribuohen, zvarritjen e zbardhjes së vendimeve të gjykatave që shkojnë dhe deri në 6 muaj nga dita e shpalljes së vendimit, mungesën efektive të avokatëve mbrojtës, etj. Të paraburgosurve nga grupi i inspektimit ju dhanë këshillime ligjore për mënyrën e ndjekjes së këtyre ankesave, pasi nisur nga natyra e ankesave që ato paraqiten, vlerësohet se objekti i shqyrtimit ligjor nga Mekanizmi Kombëtar dhe Institucioni i Avokatit të Popullit është jashtë kompetencave funksionale.

Gjithashtu, një shqetësim i ngritur nga të paraburgosurit ishte mungesa e një njësie tregtare për sigurimin e produkteve bazë dhe të domosdoshme personale. Ata pohuan se ofrimi i një shërbimi të tillë do të jetë një lehtësim për të patur në çdo kohë produktet bazë të domosdoshme për të jetuar.

Masat mbrojtëse

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte normalisht, pasi çdo formular regjistrohej në regjistrin përkatës dhe më tej protokollohej³. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit plotësonin formularin e kërkesë/ankesës dhe e hidhnin në kutinë postare ose ia dorëzonin punonjësit

³ Neni 10 i ligjit Nr. 81/2020 dt. 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

të sektorit juridik. Më tej, ato dërgoheshin në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të paraburgosurit.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, për shkak të mungesës së infrastrukturës ndarja e të paraburgosurve në seksione të veçanta sipas kategorive 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁴, nuk mund të realizohej. Institucioni kishte vetëm një ambient në regjimin e brendshëm, i cili ishte i ndarë në dhoma dhe jo me seksione. Në momentin e inspektimit në ambientet e regjimit të brendshëm ndodheshin 4 persona me probleme të shëndetit mendor dhe 1 person abuzues me substanca narkotike. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta ishte i pamundur për shkak të mungesës së ambienteve në institucion.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Sarandë, **nuk** kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, në një kohë ku për këto individë duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjinës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012, “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar ku thuhet se: "Ekipet multidisiplinare" janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor.⁵

Në IEVP Sarandë ishte një dhomë observim/veçimi e cila ndodhej në fund të korridorit të regjimit, me sipërfaqe 3x4m². Ajo ishte e pajisur me një krevat dhe një dyshek për akomodimin e të paraburgosurit, por kishte nevojë për lyrje dhe mbajtjen pastër nga ana higjieno-sanitare. Po ashtu, mungonte ndriçimi natyral dhe ajrosja sigurohej nga një dritare shumë e vogël. Gjithashtu në dhomë mungonin stola, tavolina dhe pajisja me materiale dhe orënditë e nevojshme për këtë qëllim. Në këto kushte nuk plotësohet standartin sipas ligjit.

Sistemi i monitorimit me kamera në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm ishin instaluar dhe ishte funksional. Kamerate mbanin në vëzhgim mjediset e këtij institucioni për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

Mungesa e ambienteve dhe mjediseve të përbashkëta që duhet të ofronin arsimim, formim profesional, zhvillim të aftësive individuale, aktivitete sociale, sportive kishte sjellë pengesa në zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese, integruese dhe psiko-sociale për të burgosurit.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në IEVP Sarandë, kishte vetëm 1 një post për takime fizike/online me familjarët e të paraburgosurit. Ndërsa dhoma prindërimi

⁴ Neni 29, pika 1 dhe 2, të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

⁵ Pika 4 të nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

në distancë dhe dhoma për takime speciale me familjarët nuk kishte. Nga intervistat, rezultoi se të paraburgosurit zhvillonin 4 takime fizike, ku një nga këto takime me kërkesë të burgosurit mund të bëhet online, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve.

Komunikimet me telefon me familjet e tyre, të burgosurit i zhvillonin normalisht me telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre. Nga kontakti me të burgosurit konstatuam se ata mund të komunikonin lirisht me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në I EVP Sarandë ishin të punësuar 2 të paraburgosur, nga 3 që ishin miratuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, etj. Sipas intervistave me të paraburgosurit, punësimi paraqet interes për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 209 datë 06.04.2022, si dhe VKM nr.602 datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”; të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 “Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në I EVP dhe pagesat e tyre”.

Kushtet materiale

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës monitoruese në I EVP Sarandë, i kushtoi një interes të veçantë plotësimit të kushteve materiale në funksion të të paraburgosurve, për respektimin e standardeve normale për jetesë, si dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, me qëllim rehabilitimin e tyre.

Godina kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, është e organizuar me 1 sektor, pasi godina ishte gjysëm nëntokë dhe përbëhej nga 12 dhoma. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina, stola dhe rafte për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Kushtet materiale në regjimin e brendshëm të institucionit ishin në përgjithësi të përmirësuar, pavarësisht pozicionit të disfavorshëm në të cilën ndodhet godina, në nivelin e tokës. Nga ana e institucionit, ishin kryer disa investime me fondet e tyre, për reduktimin e nivelit të lagështirës në ambientet e dhomave, si dhe në tualetet e dushet e përbashkëta. 12 dhomat e banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishte krijuar një ambient i veçantë për ajrimin e të paraburgosurve.

Kubatura e dhomave ishte më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja banimit ishte më pak se 4 m², për çdo të burgosur⁶. Përmasat e dhomave ishin të vogla dhe ishin të papërshtatshme. Në dhoma ishin akomoduar 2, 3 dhe 6 persona.

⁶ Neni 33 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

Në këto kushte, duke vlerësuar kushtet e klimës së zonës, hapësirës së nevojshme për jetesë për person, mungesës së ajrimit, ndriçimit, mjediseve të pamjaftueshme në regjimin e brendshëm në këtë institucion, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, përgjithësisht ambientet e qëndrimit nuk garantojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe nuk plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike sipas standardeve që parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve.

Gjithashtu, u evidentua se dritaret e dhomave të banimit ishin me përmasa të vogla 80x60 cm, të cilat nuk mundësonin ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për jetesë të të paraburgosurve. Në pjesën e jashtme ato ishin të përforcuara me skara hekuri. Mundësia e zgjerimit të dritareve është e pamundur, për shkak të strukturës dhe pozicionit, të godinës së regjimit të brendshëm në nivelin e tokës.

Kushtet materiale në regjimin e brendshëm të IEVP Sarandë, në tërësinë e tyre bien në kundërshtim me Rregullin 13 “Rregullat e Mandelës”, të miratuara nga OKB, ku përcaktohet shprehimisht se “Hapësirat e akomodimit për të burgosurit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore. Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet kushteve klimatike dhe veçanërisht ajrosjes, hapësirës minimale për banim, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit”.

Ambienti i tualeteve dhe dusheve ishte i plotësuar me pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për plotësimin e nevojave vetjake të higjienës.

Mjedisi i ajrimit në këtë institucion ishte krijuar në një ambient të përshtatshëm për qëndrimin deri në 10-15 persona, ku gjithashtu ishin vendosur 6 stola për uljen e të paraburgosurve gjatë ajrimit. Hapësira e ajrimit ishte e mbuluar dhe përmbushte standardet për ajrim.

Për larjen e ndërresave të të paraburgosurve, mungonte lavanderia, por si e tillë shërbente një lavatriçe e cila funksiononte dhe ishte e vendosur në hyrje të regjimit të brendshëm. Ajo përdorej vetëm për larjen e ndërresave apo të çarçafëve, por sipas pretendimit të të paraburgosurve ky proces vonohej shumë ndaj ata preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familjet e tyre.

Kuzhina e institucionit ndodhej jashtë ambientit të regjimit të brendshëm. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të vogël, por mbahej pastër nga personeli i saj. Gatimi i ushqimit dhe ruajtja e produkteve ushqimore kryhej në të njëjtin ambient. Gatimi kryhej me sobë me energji elektrike, për të paraburgosurit e IEVP-së, për 3 vakte ushqimore. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme dhe konsumohej nga të paraburgosurit.

Në rastet kur kishte të sëmurë me diabet, ushqimi gatuhej më vete. Personeli i kuzhinës sipas organikës përbëhej nga 2 punonjës. Në një stendë të vendosur në mur ishte e afishuar menuja javore me kuotat ditore dhe vlerat kalorike, të cilat rezultuan se ishin brenda normativave. Gjatë inspektimit u konstatua se kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

4. Regjimi dhe aktivitetet

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, ishte i afishuar. Në ambientet e IEVP-së ishin të afishuara posterat e Avokatit të Popullit, ku specifikoheshin të drejtat e të paraburgosurve, gjithashtu edhe numrat e kontaktit. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet që kryhej sipas parashikimeve ligjore.

Në lidhje me ajrimin, rezultoi se të paraburgosurit qëndronin në 4-5 orë në ajrim, 2-3 orë paradite dhe 2 orë pasdite. Në ambientet e ajrimit zhvilloheshin lojëra si shah, domino, letra etj., ndërsa hapësira për ecje ishte mjaft e kufizuar.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, mungonin pothuajse fare aktivitetet sociale dhe rehabilituese, për shkak të mungesës së ambienteve të përbashkëta për kryerjen e tyre. Klasa, biblioteka dhe palestra nuk ekzistonin si ambiente në këtë institucion. Gjithashtu, nuk kishte as ambiente ku të zhvillohej shërbesa fetare apo ushtrimi i riteve.

Trajtimi i të paraburgosurve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Në vijim plani individual i trajtimit hartohet nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe ofrohet prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Planin individual i trajtimit mund të ndryshojë duke iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të tjera. I paraburgosuri inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve riedukuese në institucion.⁷

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit duhet të jetë proaktiv për të krijuar sa më shumë aktivitet, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të paraburgosurve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut.

Avokati i Popullit vlerëson se ky institucion nuk i ka kushtet infrastrukurore për të realizuar procesin e rehabilitimit dhe realizimit të të paraburgosurve siç parashikohet nga ligji nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në këto kushte, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Sarandë është i domosdoshëm organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, çlodhëse e sportive me të paraburgosurit.

Në këtë kuadër, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁸.

⁷ Neni 12, pika 1 dhe 2 të ligjit Nr. 81/2020 dt. 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

⁸Rregullorja Evropiane e Burgjeve; Pika 25/1 dhe 25/2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

5. Shërbimi shëndetësor

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek dhe 4 infermierë. Aktualisht, mjeku punonte me kontratë me kohë të pjesshme, 4 orë në ditë, por ai nuk ishte prezent në institucion çdo ditë, duke krijuar probleme me stafin dhe të paraburgosurit e këtij institucioni. Nisur nga ankesat e lartëpërmendura të të paraburgosurve, por dhe pretendimet e Drejtorit të institucionit për disiplinën në punë, del nevoja e zëvendësimit të mjekut aktual me mjek tjetër, qoftë edhe me kohë të pjesshme. Gjithashtu referuar organikës ishte në mungesë edhe një infermier.

Në organikën e I EVP Sarandë nuk kishte stomatolog, kështu që në kushte të tilla, shërbimi stomatologjik mundësohej jashtë institucionit nga ofrues privat dhe mbulohej financiarisht nga familjarët e të burgosurve.

Referuar nenit 41 të ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në pikën 3 thuhet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Organizimi dhe realizimi i kujdesit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë”. Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon shtimin në organikë të pozicionit për stomatolog dhe krijimin e një dhomë të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim në lidhje me ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e infermierit, stomatologut si dhe e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t’i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua se regjistrat e terapisë ditore, marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, kartelave dhe ngjarjeve të rënda ishin të plotësuar dhe mbajtur në mënyrë të rregullt. Kartelat mjekësore të të paraburgosurve, mbaheshin me çelës në zyrën e mjekut/infermierit, e cila shërbente njëkohësisht edhe si zyrë për financën dhe logjistikën.

Dhoma e infermierisë, ndodhej në regjimin e brendshëm dhe ishte e rregullt dhe e mirëmbajtur, e pajisur me shtrat, tavolinë pune dhe rafte për mbajtjen e medikamenteve dhe regjistrat ku evidentoheshin rastet e dhënies së ndihmës mjekësore për të paraburgosurit.

Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje në shërbim mjekësor, ku KPT ka rekomanduar se “*Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*” dhe se “*shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme*”.

Por pavarësisht gjendjes së shërbimit shëndetësor, gjatë vizitës inspektuese në këtë institucion dhe nga intervistat me të paraburgosurit, kishte disa ankesa për sa i përket

vonesave për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku dhe për vizitë tek specialistët e Spitalit Rajonal Sarandë. Është për tu theksuar se Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*⁹.

Një problem shqetësues në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë ishte dhe mungesa e një autoambulance, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në Spitalin Rajonal Sarandë. Në këto kushte, nga drejtuesi i institucionit u informuam se, në rastet e emergjencave, transporti i të sëmurëve për në Spitalin Rajonal Sarandë, kryhej me autoambulancat e Shërbimit të Urgjencës Sarandë, duke marrë masa shtesë për sigurinë fizike të të paraburgosurve. Ambienti ku kryheshin vizitat mjekësore ishte një mjedis i vogël dhe nuk kishte orënditë e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Dhënia e ilaçeve të të paraburgosurve kryhej sipas recetës së firmosur nga mjeku, me ilaçe të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ilaçe të siguruara nga fondi në dispozicion të këtij institucioni. Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte për shkak të mungesës së marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike dhe në shumë raste ilaçet siguroheshin nga familjarët e të paraburgosurve.

Në IEVP kishte disa të paraburgosur me probleme shëndetsore e konkretisht, 1 i sëmurë me diabet si dhe 4 persona të sëmurë të shëndetit mendor, të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, u informuam se IEVP Sarandë është në proces mbyllje për shkak të infrastrukturës në të cilën ndodhet por edhe të riorganizimit të të burgosurve pranë vendbanimit tyre, në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Avokati i Poullit përshendet këtë vendim pasi në vite situata në këtë institucion nuk ka garantuar trajtimin dinjitoz për të paraburgosurit.

Përsa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

1. Deri në mbylljen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, të merren masa për përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr. 81/2020 datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, pasi në këtë institucion vazhdojnë të mbahen dhe trajtohen persona të paraburgosur në kushte jo humane dhe degraduese.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në IEVP Sarandë, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës me një psikolog dhe të stafit mjekësor të institucionit me mjek të përgjithshëm me kohë të plotë, stomatolog, farmacistit të punësuar me kohë të plotë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor.
4. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm me hapësirë dhe të plotësuar me materialet e nevojshme, i destinuar për ushtrimin e detyrës të specialistëve të sektorit të edukimit.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për fillimin të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.
6. Marrjen e masave për rritjen e pranisë së punonjësve të sektorit juridik në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV), në IEVP Sarandë.
8. Të merren masa të menjëhershme për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori.
9. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e palestrës me materiale, si gira, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera që ndihmojnë të paraburgosurit të kalojnë kohë çlodhëse në këtë drejtim.
10. Marrjen e masave për sigurimin e ilaçeve të të paraburgosurve nga skema e ribursimit duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike.
11. Marrjen e masave të nevojshme për hapjen e njësisë tregtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të paraburgosurit në IEVP Sarandë.

12. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Sarandë apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
13. Marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI